

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “Vlora Investment Group”SH.P.K.

### TITULLI I

#### Dizpozita te përgjithshme

##### Neni 1

Sot, me date 29.12.2023 (dymije e njetetete),ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar,respektivisht te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ,Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, krijohet shoqëria tregtare me emërtimin “Vlora Investment Group”SH.P.K., e cila do te veproje në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nenet e ketij akti.

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

##### Neni 2

Themeluesi i shoqerise “Vlora Investment Group”SH.P.K.eshte:

- **Z.BESIM BERISHA** ,shtetas Kosovar, i datëlindjes 14-10-1977 , atesia **Nazmi**, lindur në Dobercan dhe banues në Prishtine, me adrese Rruga”Kerem Leton PN,Prishtine, 10000,Kosove ,i pajisur me nr pasaporte ID1918432.,me nr personal 1170995895
- **Z.GERALD CRAIG WELLER** ,shtetas Amerikan, i datëlindjes 07-07-1957 , atesia **Anton Lavern Weller** lindur në Illinois U.S.A dhe banues në U.S.A, me adrese 500 S Australian Ave STE 600, West Palm Beach FL 33401 ,i pajisur me nr pasaporte 642630401

##### Neni 3

Forma ligjore e shoqerise do te jete “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar”ose SHPK Megjithate, ajo mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin tregetar shqiptar ne fuqi.

##### Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:  
**Shitje-Blerje te pronave te patundshme.**

**Neni 5**

Shoqeria e ka seline e saj ne:

**Vlore,Rruga”Dhimiter Konomi”,Shkolla Zeneli,kati 1/4 Murraj,Lagjja Uji i ftohte Vlore**

Ajo mund te celë dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise si dhe jashte saj.

**Neni 6**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

**Neni 7**

Shoqeria ka vulen e saj.

**TITULLI II**

**Kapitali**

**Neni 8**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **100.000** (njqindmije) leke  
Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre te meposhtem:

Aksioneret e shoqerise zoterojne dhe perqindje te kapitalit si me poshte

**1-Z.BESIM BERISHA**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 50.000 leke  
qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise

**2-Z.GERALD CRAIG WELLER**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale  
50.000 leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

**Neni 9**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.  
Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin  
themeltar te shoqerise.



Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohej per ndryshimin e aktit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni 10**

Ortaku mund te transferoje te tretteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te trette do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

#### **Organet vendimmarrese dhe drejtuese**

#### **Neni 11**

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

### **TITULLI III**

#### **Asambleja e ortakeve**

#### **Neni 12**

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarresi i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

#### **Neni 13**

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;

dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **Neni 14**

Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperem te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

#### **Neni 15**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **Neni 16**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri te katertat ( $\frac{3}{4}$ ) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

a) Ndryshimin e statutit,

b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,

c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore

ç) Shpërndarjen e fitimeve,

d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) Përcaktimin e shpërblimeve
- d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## TITULLI IV

### Administrimi

#### Neni 17

Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona si administrator të shoqërisë. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

#### Neni 18

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 5 të këtij akti.

Organi Administrativ (administratori) ka të drejtë dhe duhet të:

- a) Kryej me mirëbesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve e në interesin me të mirë të shoqërisë në tërësi;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) Te punesoj, te pezulloje, te pushoj nga puna dhe te ndryshoj kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit
- g) Përfaqësojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;





h) Te cele llogari rrjedhese bankare,te kryeje teheqje depozitim dhe teheqje parash,te jap dispozita te pageses,te verifikoje llogarite rrjedhese dhe te miratoje llogarine.

i) Te perfaqesoje shoqerine prane organeve publike,tatimore dhe administrative,edhe me qellim fitimin e koncesioneve,licencave dhe lejeve,duke emeruar,nese eshte e nevojshme mbrojttes te posacem.

j) Te nenshkruaj kontrat a shitblerje te mallrave dhe sherbimeve,ne kufijte e objektit te shoqerise.

Nese asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

#### **Neni 19**

Administrator i shoqerise **“Vlora Investment Group”SH.P.K.**,emerohet:

- **Z.VALTON HOTI ,shtetas Kosovar, i datëlindjes 07-04-1978, atesia Hasan** lindur në Gjilan dhe banues në Prishine, me adrese Rruga Tirana, kompleksi ‘Ramiz Sadiku’, C4/1 Hyrja A Nr. 33,Prishtine, Kosove 10000. Kosove ,i pajisur me nr letërnjoftimi ID021408.,me nr personal 1249998245
- Afati i mandatit te administratorit do te jete **5 vjet** nga data e miratimit te ketij statuti.

#### **Kushtet ekonomike**

#### **Neni 20**

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjetër juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

#### **Neni 21**

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise.

Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

#### **Neni 22**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 22**

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete akt do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

## **Dispozita te vecanta**

### **Prishja – Riorganizimi i Shoqerise**

## **Neni 24**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

## **Neni 25**

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

## **Neni 26**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.

## **Baza ligjore**

**Neni 27**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republikën e Shqiperise.

**Neni 28**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikës se Shqiperise per zgjidhje.

**Neni 29**

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te shoqerise duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Adresa e emailit te shoqerise eshte **tony@viptv.com**

Numri i telefonit do te jete **+38345956935**

Lexuar, miratuar dhe nenshkruar

Vlore me 29.12.2023

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**  
**"Vlora Investment Group"SH.P.K.**

**BESIM BERISHA**



Valkan Hoti



**GERALD CRAIG WELLER**

